Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deonićarsko Društvo
Nr. 9914 Data. 05.11.2026
Mitrovicë Mitrovica

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonićarsko Društvo / Trepça Joint Stok Company

TREPÇA

Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2, nenit 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në Rregulloren nr. 2778 të datës 26.05.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Stantërg, Trepça Sh.A me datë 05.11.2026 publikon këtë:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Drejtues i elektros
Koeficienti/Paga:	960€ bruto
Nr. i kërkuar:	1
Kohëzgjatja e emërimit:	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
Data e njoftimit:	05.11.2026
Afati për aplikim:	06.11.2026 – 20.11.2026
Institucioni:	Ndërmarrja " Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore:	Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg
Vendi i punës:	Stan Tërg

1.Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Është përgjegjës për dhënien e udhëzimeve për punë, për të gjitha vendet e punës ne shërbimin elektrik;
- Në bashkëveprim me udhëheqësin teknik dhe brigadierët bënë përgatitjen e planeve te punës si dhe përgatitjen e pjesëve rezervë si dhe plane afatgjate tekniko-investive, dhe bënë përcjelljen e realizimit te tyre;
- Bënë kontrollimin e punëve dhe zbatimin e normave mbrojtëse sipas normave ekzistuese;
- Kryen edhe detyra tjera qe dalin nga stafi organizativ i njësive punuese;
- Drejtërdrejt i përgjigjet drejtorit të elektromakinerisë.

2.Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

3. Kriteret e veçanta

- Të posedojë diplomë universitare - inxhinier i diplomuar i elektros - energjetikës apo master
- Duhet të ketë së paku 5 vite përvojë pune profesionale

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;

- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për vepër penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

a. Testimi me shkrim- 100 pikë

b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes ueb faqes së ndërmarrjes "Trepça Sh.A." në linkun https://trepcasha.com/ , tek kategoria Shpallje.

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.- Parku Indurstial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00- 16:00.

8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes "Trepça Sh.A."

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A
Kryeshefi Ekzekutiv

Faton Ahmeti

Trepça - Shoqëri Aksionare - Joint stock company - Deoničarsko društvo
Mitrovicë Mitrovica